




ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHETETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Raport monitorimi nr.03/2021
-

Kuvendi nën thjerrëz: Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend (gusht - dhjetor 2020)

Autore: Vlora Reçica dhe Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq
-

shkurt 2021



Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civils" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

Përmbajtja

I.	Metodologjia e hulumtimit	6
II.	Konteksti politik	7
III.	Rezume	9
IV.	Gjetjet nga monitorimi	10
	Vlerësimi i cilësisë së debatit	10
	Lloji i diskutimeve	10
	Shkalla e argumentimit	13
	Fuqia e argumentit më të mirë	16
	Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të trupave të pavarura dhe rregullatore	18
V.	Respekt, ndërprerje dhe kufizime	19
	Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit të deputetëve nga një parti tjetër	19
	Qëndrimi ndaj argumenteve dhe personalitetit sipas përkatësisë politike të deputetëve	21
VI.	Grupet e marginalizuara në Kuvend	24
VII.	Demografia e folësve	25
VIII.	Shtojca 1 - Indeksi i cilësisë së debatit	26

Impresum

Titulli: Kuvendi nën thjerrëz: Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend (gusht - dhjetor 2020)

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Autore: Vlora Reçica dhe Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.idscs.org.mk>



Hyrje

Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup (IDSCS), që nga qershori i vitit 2014, monitoron cilësinë e debatit në Kuvend dhe raportimin mediatik për punën e Kuvendit. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua për 10 muaj, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015. Nga shtatori i vitit 2015 vijoi periudha e dytë e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së debatit parlamentar dhe mbulimit mediatik, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që zgjati deri në dhjetor të vitit 2017. Periudha e tretë e monitorimit të cilësisë së debatit filloi në janar të vitit 2018 dhe zgjati deri në dhjetor të vitit 2019.

Që nga janari i vitit 2020, Instituti për Demokraci monitoron punën e Kuvendit dhe cilësinë e debatit në kuadër të **Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP)**, i cili zbatohet në partneritet me Institutin Demokratik Nacional (NDI) dhe Qendrën për Menaxhimin me Ndryshime (QMN). Më 16 shkurt të vitit 2020, Kuvendi u shpërnda dhe u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare që ishin planifikuar fillimisht për 12 prill 2020, por për shkak të pandemisë me Kovid 19, u zhvilluan më 15 korrik 2020. Prandaj, në periudhën shkurt - korrik 2020, monitorimi i debatit parlamentar u ndalua dhe nuk kishte raport.

Monitorimi në këtë periudhë përqendrohet në diskutime mbi çështjet të cilat janë pika nga rendi i ditës së parlamentit, të cilat bëjnë pjesë në fushat e sundimit të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe demokracisë. Në këtë drejtim, monitorohen ato trupa pune të Kuvendit dhe seancat plenare në fushëveprimin e të cilave bëjnë pjesë fushat e lartë përmendura. Gjatë monitorimit, gjetjet mbi cilësinë e debatit në Parlament publikohen në raporte gjysmë vjetore.

Para jush është raporti për cilësinë e debatit në Kuvend, i cili i referohet periudhës nga 4 gusht deri më 31 dhjetor 2020.

I. Metodologjia e hulumtimit

Cilësia e debatit në Kuvend është analizuar me përdorimin e "Indeksit të Cilësisë së Debatit". Indeksi është instrument që lejon secili akt individual i fjalës në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkalla e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në secilin diskutim);
- shkalla e respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumentet e tyre;
- hapja për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshimi i qëndrimeve individuale për shkak të argumenteve më cilësore të paraqitura në debat;
- nëse deputetët mund të shprehin lirisht qëndrimet e tyre.

Nga janari 2018, vendoset një mënyrë e re e vlerësimit të cilësisë së debatit. Në Raportet gjysmë-vjetore mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend gjithashtu përfshihet edhe **vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së debatit sipas Indeksit të cilësisë së debatit - Discourse Quality Index (DQI)**. Ky indeks jep notën mesatare prej 1 deri në 10 për cilësinë e debatit në Kuvend.

Me këtë indeks përfshihen Shkalla e arsytimit (20% të notës), përfshirja e arsytimit (5%), përgjegjësia (20%), forca e argumentit më të mirë (20%), raporti ndaj pjesëmarrësve të partisë tjetër (10%), raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve nga parti tjetër (10%), raporti ndaj pjesëmarrësve të jashtëm (2,5%), raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm (2,5%), ndërprerje (5%) dhe kufizim (5%) si indikatorë.

Një (1), si nota më e ulët do të thotë se deputetët nuk përdorin asnjë argument gjatë fjalimeve të tyre, nuk u referohen parimeve të caktuara, i shtrembërojnë argumentet, nuk ndryshojnë pozicionin e tyre dhe nuk pranojnë argumente, nuk kanë referencë ndaj argumenteve të tjerëve ose kanë ndryshim të qëndrimit, por jo për shkak të argumenteve të tjetrit. Nota një (1) gjithashtu do të thotë që deputetët tregojnë mosrespektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë dhe argumenteve të tyre (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), se ka ndërprerje të diskutimit dhe se në një moment ka pasur ndërprerje fizike të folësve. Nga ana tjetër, nota dhjetë (10), që do të thotë se cilësia e debatit është e shkëlqyeshme, do të thotë që deputetët përdorin më shumë se dy argumente, ose të paktën një argument gjatë fjalimeve të tyre, i referohen parimeve të caktuara, adresojnë argumentet në përputhje me rrethanat, ka ndryshim të qëndrimit për shkak të argumenteve më të mira, tregojnë respekt për personin dhe argumentet e pjesëmarrësve të tjerë në diskutim (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), nuk ka ndërprerje të diskutimit dhe nuk ka asnjë kufizim të së drejtës për fjalë.

Më shumë detaje rreth vlerësimit ka në Shtojcën 1.

II. Konteksti politik

Sipas Kushtetutës, Kuvendi ka pushtet legjislativ dhe aktualisht përbëhet nga 120 deputetë. Deputetët zgjidhen me zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave zgjedhore proporcionale për mandat prej katër vjetësh. Duke vazhduar "traditën" joformale të vendit, në tetor 2019 Kryeministri i qeverisë së atëhershme të LSDM-së, Zoran Zaev paralajmëroi takim të liderëve në të cilin do të propozojë zgjedhje të parakohshme parlamentare,¹ të pestat me radhë për vendin. Zgjedhjet erdhën pasi vendi nuk ishte në gjendje të hapte negociatat me Bashkimin Evropian (BE) për shkak të vetos franceze dhe besimit të lëkundur në qeverinë e LSDM-së, platforma e së cilës bazohej kryesisht në rrugën e pandërprerë të vendit drejt BE-së. Në shkurt të vitit 2020, në seancën e 137-të të Kuvendit, me 113 vota pro dhe asnjë kundër ose të përmbajtur, unanimisht u miratua vendimi për shpërndarjen e tij, ndërsa të nesërmen, më 17 shkurt, Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, i shpalli zgjedhjet² më 12 prill.³ Pavarësisht planeve, zgjedhjet parlamentare të mbahen në prill, për shkak të përkeqësimit të situatës së koronavirusit, ato do të prolongohen.

Në mars të vitit 2020, Presidenti i shtetit do të shpallë gjendje të jashtëzakonshme, e cila do të zgjasë deri më 15 qershor, ndërsa ndërkohë partitë politike do të takohen disa herë përmes takimeve të liderëve, për përcaktimin e datës së zgjedhjeve, por edhe për masat e nevojshme për mbrojtjen e qytetarëve gjatë fushatës zgjedhore dhe votimit.

Pas disa përpjekjesh dhe negociatash, data e zgjedhjeve u caktua 15 korrik 2020, me disa masa për mbrojtjen e qytetarëve nga Covid 19. "Më 13 korrik, do të votojnë personat të cilët mjekohen në kushte shtëpie ose janë në karantinë ose izolim për shkak të Covid-19. Më 14 korrik, do të votojnë të pamundurit dhe personat e sëmurë, si dhe persona të tjerë që votojnë një ditë më parë sipas Kodit Zgjedhor. Përveç ditës shtesë për votim, risi në këto zgjedhje është edhe zgjatja e kohës së votimit më 15 korrik deri në ora 21."⁴ Votimi dhe zgjedhjet përgjithësisht u zhvilluan në mënyrë të rregullt dhe pa incidente të mëdha ose tensione.⁵

Në këto zgjedhje, LSDM dhe koalicioni "Mundemi" - fitoi 46 deputetë, VMRO-DPMNE-ja dhe koalicioni "Ripërtëritje për Maqedoninë", fituan 44 deputetë, ndërsa Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) fitoi 15 deputetë. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa fitoi 12 deputetë, E Majta fitoi 2 deputetë, ndërsa Partia Demokratike e Shqiptarëve fitoi 1 deputet. Koalicion qeveritar u formua midis LSDM-së dhe koalicionit "Mundemi" dhe BDI-së, pas negociatave disa javore midis partive politike. Me këtë koalicion, qeveria siguroi shumicën në Kuvend me 61 deputetë, ndërsa opozitës iu bashkuan VMRO-DPMNE-ja dhe Koalicioni "Ripërtëritje për Maqedoninë", Koalicioni Aleanca e Shqiptarëve dhe Alternativa, E Majta dhe PDSH-ja. Në përbërjen e re parlamentare, 80

¹ "Zaev: Shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme", Deutsche Welle, 19 tetor 2019. Mundësuar në: <https://p.dw.com/p/3RYux> (vizita e fundit: 10 mars 2020)

² Aktvendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktvendimi është marrë nga ueb faqja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). Mundësuar në: https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2020/?_thumbnail_id=6946 (vizita e fundit: 9 Mars 2020)

³ Pankovski, M. dhe të tjerët (2020) Doracak për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020: Botimi i dytë i plotësuar. Fondacioni Konrad Adenauer, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

⁴ Ibid

⁵ Misioni Special për Vlerësimin e Zgjedhjeve të ODIHR-së https://www.osce.org/files/f/documents/b/e/465648_2.pdf

nga 120 deputetë u zgjodhën për herë të parë, përkatësisht u gjetën në rolin e deputetit për herë të parë në karrierën e tyre.⁶

Seanca konstituive e Kuvendit të ri u mbajt më 4 gusht, ndërsa Kuvendi do të vazhdojë me seanca të rregullta plenare nga data 25 i të njëjtit muaj. Në periudhën ndërmjet shpalljes së parë të zgjedhjeve dhe konstitumit të Kuvendit kaluan pesë muaj.

Në mars të vitit 2020, Presidenti shpalli gjendje të jashtëzakonshme, e cila sipas Kushtetutës duhet të konfirmohet nga Kuvendi, por Kryetari i atëhershëm i Kuvendit, Talat Xhaferi, refuzoi të konvokonte seancë parlamentare, duke thënë se nuk ishte e mundur sepse Kuvendi tashmë është vetë shpërndarë.⁷ Nga ana tjetër, 35 deputetë nënshkruan dhe paraqitën iniciativë për konvokimin e seancës parlamentare urgjente, e cila ishte e pasuksesshme. Kjo iniciativë u nënshkrua nga deputetët nga LSDM-së, BESA, PDSH dhe grupi i pavarur parlamentar, ndërsa nuk u mbështet nga VMRO-DPMNE-ja dhe BDI-ja. Me Kuvend të shpërndarë dhe gjendje të jashtëzakonshme kishte shqetësim të zmadhuar në lidhje me përkeqësimin e mundshëm të proceseve demokratike dhe të drejtave të njeriut. Kjo situatë u përkeqësua veçanërisht nga fakti që në atë periudhë kishte mungesë mbikëqyrjeje nga Kuvendi mbi pushtetin ekzekutiv, i cili nga ana tjetër mori kompetenca legjislative përmes mundësisë së propozimit të urdhëresave me fuqi ligji.⁸

⁶ Hayslet, R.E. (2020) Lotaria në Supermarket: Si partitë politike përdorin listat e mbyllura të kandidatëve për të ruajtur kontrollin. Ballë për ballë. Në dispozicion në: shorturl.at/nAHIT.

⁷ "Xhaferi: Nuk kam mandat me akt individual të anuluar vendimin për shpërndarjen e Kuvendit." Qasur në: <https://360stepeni.mk/>, (vizita e fundit: 11 qershor 2020).

⁸ Recica V. (2020) What is the general perception of citizens about the Assembly of Republic of North Macedonia? Institute for Democracy "Societas Civilis" – Skopje <https://bit.ly/3iOBtMt>

III. Rezume

Raporti konfirmon nivelin e ulët të cilësisë së debatit në Kuvend në 2 vitet e fundit, si dhe përfundimin se ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësim. Në shkallën nga 1 - më e ulëta në 10 - më e larta, nota mesatare e cilësisë së debatit në Kuvend është 5.5 dhe është më e ulët krahasuar me periudhat e mëparshme të monitorimit.

Deputetët e opozitës ishin më aktivë me pjesëmarrjen në diskutime, duke marrë pjesë në 61% të diskutimeve të monitoruara, ndërsa deputetët e pushtetit morën pjesë në 39%. Më shpesh për fjalë është paraqitur dhe më gjatë në foltoren e deputetëve ka qëndruar Bojan Stojanoski. Midis 10 deputetëve më aktivë, u gjenden edhe tre deputete, Gordana Siljanovska Davkova, Dafina Stojanoska dhe Zhaklina Llazarevska, një deputete më shumë krahasuar me periudhën e mëparshme (korrik - dhjetor 2020).

Raporti shënon nivel të ngjashëm të ndërveprimit dhe shkëmbimit të qëndrimeve midis pjesëmarrësve në diskutim me periudhën e paraprake të monitorimit (korrik - dhjetor 2020). Gjatë periudhës së monitorimit, u mbajt vetëm një seancë parlamentare, pyetje deputetësh. Për sa i përket argumentimit të diskutimeve, në përgjithësi vërehet rënie e konsiderueshme e argumentimit krahasuar me periudhën e mëparshme. Në 44% të fjalimeve të tyre, folësit nuk kishin argumente, ndërsa në 45% ata argumentuan dobët. Një ose më shumë argumente u shënuan në vetëm 11% të diskutimit, në krahasim me 29% në periudhën paraprake të monitorimit.

Përqindja e ndryshimit të qëndrimit për shkak të argumenteve më të mira mbetet dukshëm e ulët, që të mund të konkludohet se deputetët demonstrojnë

mundësinë e hapjes për korrektësinë e argumenteve të palës tjetër. Në 54% të diskutimeve, deputetët nuk i referohen forcës dhe cilësisë së argumenteve të folësve të tjerë, ndërsa në 37% deputetët mbetën në pozicionin e tyre dhe nuk e njohën vlerën e argumenteve të kolegëve të tyre të opsioneve të tjera politike, që është për 27% më e lartë se periudha paraprake (10%).

Deputetët i referohen më shumë shqyrtimit të personalitetit të bashkëbiseduesve sesa argumenteve të tyre. Në 16% të fjalimeve, deputetët kanë shprehur respekt ose respekt të pjesshëm për argumentet e deputetëve nga partia tjetër politike, ndërsa mosrespektim ose mosrespektim të pjesshëm të argumenteve kanë shprehur në 26% të diskutimit. Respekt ose respekt të pjesshëm për personalitetin e tyre kanë

shprehur në 32%, ndërsa mosrespektim ose mosrespektim të pjesshëm kanë shprehur në 20% të diskutimit.

Raporti konfirmon edhe vëmendjen vazhdimisht të ulët të deputetëve për të drejtat e grupeve të marginalizuara, gjatë të gjitha periudhave të monitorimit. Është vërejtur se deputetët në mbi 93% të diskutimeve të tyre, nuk flasin në lidhje me të drejtat e grupeve të marginalizuara, përveç nëse diskutohet specifikisht ligj ose temë e caktuar, në rendin e ditës në lidhje me të drejtat e tyre. Ngjashëm me periudhën e mëparshme (korrik - dhjetor 2019), asnjë grup i marginalizuar nuk është përfaqësuar më shumë se 3% në diskutime.

IV. Gjetjet nga monitorimi

■ Vlerësimi i cilësisë së debatit

Nota për cilësinë e debatit për këtë periudhë, në shkallën nga 1 në 10 është 5,5 - që do të thotë rënie e cilësisë së diskutimit krahasuar me periudhën **korrik - dhjetor 2019**, për të cilin nota për cilësinë e debatit ishte 6,0. Këtë periudhë të monitorimit, nota për debatin në Kuvend është në nivelin më të ulët, krahasuar me periudhat e kaluara në vitin 2018 dhe 2019. **Për dallim nga periudhat paraprake, cilësia e debatit në Kuvend nuk fiton notën minimale të nevojshme, që të quhet debat.** Në notën e cilësisë së

debatit, më shumë kontribuojnë shkalla e arsyetimit, përgjegjësia dhe fuqia e argumentit më të mirë.


Në këtë periudhë shohim më pak përgjegjësi të deputetëve, si dhe rënie të nivelit të arsyetimit dhe forcës së argumentit më të mirë. Si pasojë, kjo rënie reflektohet në vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së debatit. **Në përgjithësi, cilësia e debatit, si në periudhën e mëparshme, është në nivel të ulët, me shumë hapësirë për përmirësim.**

■ Lloji i diskutimeve

Gjatë kësaj periudhe (gusht - dhjetor 2020) 64% e diskutimeve të monitoruara ishin pjesë e seancave plenare, ndërsa 36% e diskutimeve të komisioneve,⁹ ndërsa gjithsej janë monitoruar 1605 diskutime (të deputetëve dhe pjesëmarrësve të jashtëm në debat). 47% e diskutimeve iu referuan ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve, ndërsa 24% projektligjeve. 23%

e diskutimeve iu referuan akteve të tjera, ndërsa 3% pyetjeve parlamentare dhe seancave mbikëqyrëse njësoj. Si propozues të aktit, në 84% të diskutimeve paraqitet qeveria, ndërsa në 16% deputetët. Në 11% të diskutimeve, janë shqyrtuar akte të cilat në Kuvend ishin të paraqitura me procedurë të shkurtuar. Sipas monitorimit, shumica e diskutimeve ishin në lidhje

Grafiku 1. Përkatësia politike e deputetëve (%)




⁹ Komisioni Ligjvënës, Komisioni për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet Ndërmjet Bashkësive, Komisioni për Financim dhe Buxhet, Këshilli i Buxhetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Çështje Kushtetuese, Komisioni për Çështje Ekonomike, Komisioni për Kulturë, Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Sport, Komisioni për Punë dhe Politikë Sociale, Komisioni për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave dhe Komisioni për Transport, Lidhje dhe Ekologji

me propozim buxhetin dhe propozim buxhetin e plotësuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 dhe për propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e tij, si dhe për propozimin për emërimin e Zëvendësministrave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për zgjedhjen e gjyqtarit për Gjykatën Kushtetuese. Sipas përkatësisë politike të folësve nga monitorimi

në këtë periudhë, rezulton se deputetët nga shumica e përbërë nga: LSDM-ja dhe koalicioni dhe BDI-ja morën pjesë në 39% të diskutimeve të monitoruara; ndërsa opozita, e cila përbëhet nga: VMRO-DPMNE-ja dhe koalicioni, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa, E Majta dhe PDSH-ja, morën pjesë në 61% të diskutimeve të monitoruara.


Grafiku 2. Cilët deputetë ishin më aktivët??



Më aktivët, përkatësisht deputetët të cilët qëndruan më gjatë në foltoren parlamentare, janë Bojan Stojanoski me 278 minuta, Gordana Siljanovska Davkova me 256 minuta dhe Panço Minov me 213 minuta. Sipas asaj sa herë janë paraqitur për fjalë, deputeti më aktiv është Bojan Stojanoski i cili ka marrë fjalë 57 herë, deputetja

Gordana Siljanovska Davkova me 56 herë dhe Brane Petrushevski me 46 herë. **Deputetet më aktive në këtë periudhë të monitorimit ishin deputetët e opozitës, Gordana Siljanovska Davkova, e cila në foltore qëndroi për 256 minuta dhe Dafina Stojanoska me 158 minuta.**


Grafiku 3. Lloji i diskutimeve (%)



Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, dhoma ligjvënëse është e detyruar të mbajë seancë për pyetje të deputetëve çdo të enjten e fundit të muajit.¹⁰ Në këtë periudhë monitorimi gusht - dhjetor 2020, u mbajt vetëm një seancë për pyetje deputetësh më 30 dhjetor, 2020. Pyetjet e deputetëve janë mjet kryesor për mbikëqyrjen e punës së qeverisë, por edhe për të kërkuar përgjegjësi prej saj. Prandaj, është thelbësore që

Kuvendi të organizojë në mënyrë konsekuente seancat për pyetje deputetësh. Në seancën e mbajtur, u shtruan 9 pyetje deputetësh dhe 12 pyetje plotësuese të deputetëve ose 51% e diskutimit, ndërsa pjesa tjetër e diskutimit iu kushtua përgjigjeve të pyetjeve të deputetëve (49%) nga përfaqësuesit e qeverisë. Shumica parlamentare shtroi 3 pyetje, ndërsa 18 të tjerat u shtruan nga opozita.

Grafiku 3.1 Pyetjet deputetësh - rrall (%)




¹⁰ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut <https://www.sobranie.mk/content/Delovnik%20na%20RM/DelovniknaSRMPrecistentekstAvgust13.pdf>

Duke iu referuar llojit të diskutimit sipas përkatësisë politike të folësve, mund të vërehet se shumica e diskutimit inicohet nga opozita, përmes fjalimeve të tyre (72%), ndërsa shumica e replikave i përkasin

qeverisë (53%). Pjesë më e madhe e kundër replikave i përkasin opozitës (65%). Opozitës i takojnë edhe pjesa më e madhe e vërejtjeve procedurale 59%.

Grafiku 4. Lloji i diskutimit sipas përkatësisë politike (%)




■ Shkalla e argumentimit

Në 44% të diskutimeve të analizuara, pjesëmarrësit nuk kishin argumente, ndërsa në 45% të diskutimeve të analizuara ata kishin argumentim të dobët, përkatësisht folësit ofruan shpjegim të pozicioneve të tyre, i cili nuk është i mjaftueshëm që të konsiderohet si një argument i plotë. Në 9% të diskutimit folësit përdorën vetëm një argument për të arsyetuar pozicionin e tyre. Në 2% të diskutimeve u përdorën 2 argumente, ndërsa në diskutimet e monitoruara, folësit nuk përdorën më shumë se dy argumente për të mbështetur

pozicionin e tyre. Krahasuar me mandatin e mëparshëm në periudhën korrik - dhjetor 2019, niveli i argumentimit në Kuvend shënon rënie të ndjeshme. Folësit nuk përdorën argumente në deklaratat e tyre për 16 pikë të përqindjes më shumë, ndërsa ata argumentuan dobët për 2 pikë të përqindjes, më shumë. Një argument u përdor me 16 pikë të përqindjes më pak, ndërsa dy argumente u përdorën me 2 pikë të përqindjes më pak, që do të thotë rënie e ndjeshme e nivelit të argumentimit.

Grafiku 5. Shkalla e argumentimit të diskutimeve (%)



Nëse analizohet në përputhje me përkatësinë politike të folësve, 43% e diskutimit të bërë nga deputetët e pushtetit argumentohet dobët, ndërsa në 50% nuk u identifikua asnjë arsytim në lidhje me temën e diskutimit në seancë. Vetëm në 4% të diskutimeve të shumicës është identifikuar një argument, në 2% dy argumente, ndërsa përdorimi i më shumë se dy argumenteve nuk është vërejtur. Krahasuar me argumentimin e diskutimeve në periudhën paraprake raportuese, shkalla e argumentimit të qeveria është zvogëluar në të gjitha përshkrimet. Gjegjësisht, për dallim nga periudha korrik - dhjetor 2019, për 19% më shumë, qeveria nuk kishte asnjë argument në diskutimet e saj. Gjithashtu, në periudhën paraprake raportuese, në 23% të diskutimeve u identifikua një argument, përkatësisht për 19% pikë të përqindjes më shumë krahasuar me periudhën aktuale të raportimit. Më pas, 4% e deputetëve të pushtetit përdorën dy argumente në diskutimin e tyre, përkatësisht


për 2 pikë të përqindjes më shumë krahasuar me periudhën aktuale.

Lidhur me diskutimin e deputetëve të opozitës në periudhën gusht - dhjetor 2020, 44% karakterizohen me argumente të dobëta, ndërsa në 43% të diskutimeve të tyre nuk përdorën argumente aspak. Krahasuar me periudhën e paraprake, te opozita është vërejtur rritje prej 12 pikë të përqindjes në raport me numrin e diskutimeve në të cilat nuk ka argumente (korrik - dhjetor 2019, 31%). Në 22%, deputetët e opozitës përdorën një argument, që është për 11% më shumë se periudha aktuale, ndërsa në 3% të diskutimit të tyre ata përdorën dy argumente, që është relativisht në përputhje me raportin për periudhën raportuese të mëparshme.

Gjatë kësaj periudhe, niveli i argumentimit është në nivel më të lartë tek opozita.¹¹

¹¹ Për shkak të strukturës relativisht të pandryshuar të pushtetit dhe opozitës, raporti përfshin krahasim me pushtetin dhe opozitën nga mandati i mëparshëm.


Grafiku 6. Shkalla e argumentimit të diskutimeve sipas përkatësis politike (%)



Sa i përket mënyrës se si deputetët u përgjigjen argumenteve të drejtuara nga folës të tjerë, për dallim nga periudha e mëparshme (korrik-dhjetor 2019) ku 20% e diskutimit argumentet ishin adresuar në mënyrë përkatëse, këtë periudhë vetëm në 6% e diskutimeve argumentet u ishin drejtuar në mënyrë përkatëse deputetëve, përkatësisht deputeti iu përgjigj drejtpërdrejt argumenteve të bëra paraprakisht nga pjesëmarrës tjetër në seancë. Për dallim nga periudha e mëparshme (korrik - dhjetor 2019), në të cilën në 40% të diskutimit pjesëmarrësit pjesërisht iu përgjigjën argumenteve

të adresuara, ndërsa pjesërisht i shtrembëruan ose injoruan, këtë periudhë kjo ndodhi në 28% të diskutimit. Në 12% të rasteve argumentet ishin shtrembëruar krejtësisht, që është për 5 pikë të përqindjes më shumë se në periudhën e mëparshme. Në 11% të rasteve argumentet e folësve të tjerë u injoruan plotësisht. Që është gjithashtu për 5 pikë të përqindjes më shumë se periudha paraprake e monitorimit. Në 44% të rasteve, nuk ishin adresuar argumente ose pyetje nga deputetë të tjerë, që sugjerojnë nivel të ulët të diskutimit në përgjithësi.

Grafiku 7. Përgjegjësi (%)




Analizuar sipas përkatësisë politike të folësve, rezulton se deputetët e shumicës adresuan argumentet në mënyrë përkatëse në 5% të diskutimit. Te deputetët e opozitës e njëjta u vërejt në 7% të diskutimeve.

Deputetët e opozitës në 26% të diskutimit të tyre vendosën t'u përgjigjen pjesërisht argumenteve, pjesërisht t'i shtrembërojnë ose t'i injorojnë, ndërsa deputetët e shumicës këtë e bënë në 31% të diskutimit. Shumica në 14% të diskutimit nuk i injoroi

argumentet, por i shtrembëroi, ndërsa opozita këtë e bëri në 11% të diskutimit. Shumica injoroi argumentet e pjesëmarrësve të tjerë në 11% të diskutimit, ndërsa opozita injoroi argumentet e të tjerëve në 10% të fjalimeve të tyre.

Në 39% të diskutimit të pushtetit dhe në 47% të diskutimit të opozitës, nuk janë drejtuar argumente ose pyetje folësve të tjerë, në të cilat pyetje ose argumente mund të përgjigjeshin ose adresonin.

Grafiku 8. Përgjegjësia sipas përkatësisë politike (%)




■ Fuqia e argumentit më të mirë

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në diskutimet e monitoruara, u vërejt ndryshim i qëndrimit për shkak të argumenteve më të mira në 1 rast, ndërsa ndryshim i qëndrimit, por jo për shkak të argumenteve më të mira në 2 raste edhe atë vetëm te deputetë. Për dallim nga periudha e mëparshme ku është vërejtur ndryshim i qëndrimit për shkak të argumenteve më të mira në 2 raste edhe atë vetëm te pjesëmarrës të jashtëm në diskutim. Megjithatë, ky numër mbetet dukshëm i ulët, që të mund të konkludohet se deputetët demonstrojnë mundësinë e hapjes ndaj korrektësisë së argumenteve të palës tjetër. Në 54% të diskutimeve nuk u vërejt asnjë referencë për cilësinë e argumenteve të folësve të tjerë, që është për 29% më pak se periudha e

mëparshme. Në 3% të diskutimeve te folësit, nuk kishte asnjë ndryshim të qëndrimeve për shkak se deputetët kishin të njëjtin qëndrim dhe pranuan vlerën e argumenteve të anëtarëve të partisë së tyre. Në 6% të diskutimit, deputetë nga opsione të ndryshme politike, megjithëse nuk e ndryshuan pozicionin e tyre, përsëri pranuan cilësinë dhe vlerën e argumenteve të bashkëbiseduesve të tyre nga partitë e tjera. Krahasuar me periudhën e mëparshme (korrik-dhjetor 2019), numri i diskutimeve në të cilat deputetët qëndruan në pozicionin e tyre dhe nuk e njohën vlerën e argumenteve të folësve nga opsionet e tjera politike është për 27% më i lartë, që tregon nivel më të ulët të debatit krahasuar me periudhën e mëparshme.

Grafiku 9. Fuqia e argumentit më të mirë (%)




Nëse sipas përkatësisë partiake të folësve, analizohet hapja ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë në seancat, mund të konkludohet se të dy palët ishin më të përqendruara në shprehjen e qëndrimeve të tyre. Në 51% të diskutimit të shumicës dhe 56% të opozitës, deputetët nuk folën në lidhje me argumentet e tjetrit. Krahasuar me periudhën e kaluar (korrik - dhjetor 2019), kjo shifër shënon rënie me rreth 30% si tek pushteti ashtu edhe tek opozita, për llogari të mos pranimit të argumenteve të tjetrit.

Në diskutimet e shumicës, në 37% të rasteve nuk kishte ndryshim të qëndrimit dhe vlera e

argumenteve të folësve nga opsioni tjetër nuk u pranua, e njëjta gjë ndodhi me diskutimet e opozitës (37%). Në 5% të diskutimit, shumica, megjithëse nuk e ndryshuan qëndrimin e tyre dhe e mbajtën pozicionin, përsëri pranuan vlerën e argumenteve të tjetrit. Opozita veprroi në mënyrë të ngjashme në 6% të diskutimit të tyre.

Folësit e pushtetit ndryshuan qëndrimin e tyre për shkak të argumenteve më të mira të bashkëbiseduesve të tyre në një rast, ndërsa të njëjtën gjë e bënë edhe folësit e opozitës. Folësit e opozitës gjithashtu ndryshuan qëndrimin e tyre për një pikë të rendit të ditës, por jo për shkak të argumenteve të tjetrit.

Grafiku 10. Fuqia e argumentit më të mirë sipas përkatësisëpolitike (%)



■ Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të trupave të pavarura dhe rregullatore

Nga gushti deri në dhjetor 2020, 9 raporte të trupave të pavarura dhe rregullatore u parashtruan në Kuvendin e RMV-së, për të cilat nuk u diskutuan aspak në seancat plenare dhe në komisionet. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që raportet e paraqitura në Kuvend të shqyrtohen në Kuvend,

në mënyrë që të rritet transparencja e punës së pushtetit ekzekutiv. Në këtë rast, megjithëse trupat e pavarura dhe rregullatore kanë dorëzuar raportet e tyre vjetore në Kuvend, qytetarët nuk kishin asnjë këqyrje në punën e trupave të pavarura dhe rregullatore.

Tabela 1.

Raportet e trupave të pavarura dhe rregullatore	
1	Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të dytë në Fushën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse për vitin 2019.
2	Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në vitin 2019.
3	Raport vjetor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik në vitin 2019.
4	Raport vjetor për punën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin 2019
5	Raporti vjetor për punën e Këshillit të Inspektimit për vitin 2019.
6	Raporti vjetor për punën e Komisionit të Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019
7	Raport vjetor për funksionimin e Agjencisë për Supervizion të Sigurimeve për vitin 2019
8	Raport vjetor i Agjencisë për Supervizion të Sigurimeve për gjendjen dhe lëvizjet në tregun e sigurimeve në Maqedoni në vitin 2019
9	Raport vjetor për punën e Agjencisë së Postave për vitin 2019

V. Respekt, ndërprerje dhe kufizime


■ Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit të deputetëve nga një parti tjetër

Shfaqja e formave të ndryshme të mosrespektimit të folësve ose argumenteve të tyre mund të ndryshojë atmosferën eventuale korrekte, e cila është parakusht themelor për zhvillimin e debatit racional dhe argumentues. Njëkohësisht, kjo mund të ndryshojë rrjedhën e diskutimit dhe fokusin e deputetëve nga argumentet të përqendrohet në sulme dhe fyerje, me çka në mënyrë plotësuese polarizohet atmosfera dhe pamundësohet debati thelbësor.

Gjatë kësaj periudhe, respekti ndaj argumenteve është shprehur në vetëm 4% të rasteve, ndërsa respekti i pjesshëm në 12%. Mosrespektimi i

pjesshëm është shprehur në 13% të diskutimit, që është 5 pikë të përqindjes më e lartë se në periudhën e mëparshme të monitorimit. Mosrespektimi i argumenteve të tjetrit shprehet në 13% të rasteve, që është 10% më i lartë se periudha korrik - dhjetor 2019). Nga ana tjetër, respektimi është ulur me 4 pikë të përqindjes, ndërsa respektimi i pjesshëm është ulur me 5 pikë të përqindjes. Për më tepër, për dallim nga periudha e mëparshme (korrik - dhjetor 2019) në të cilën deputetët në 63% të diskutimit nuk kishin referencë ndaj argumentit të tjetrit, këtë periudhë, kjo shifër u ul me 5 pikë të përqindje, përkatësisht në 58% të diskutimeve, deputetët nuk kishin asnjë referencë ndaj argumentit të tjetrit.

Graph 11. Raporti ndaj argumenteve të deputetëve të partive të tjera (%)




Kur bëhet fjalë për qëndrimin e deputetëve ndaj personalitetit të tjetrit, në 3% të diskutimit është shprehur respekt, ndërsa në 29% është shprehur respekt i pjesshëm, që është për 20% më shumë krahasuar me periudhën e mëparshme të monitorimit. Kjo do të thotë që deputetët nuk

rezistuan në diskutimet e tyre të përdorin shprehje tallëse ose shprehje të buta fyese dhe sulme ndaj personalitetit të kolegëve të tyre nga opsionet e kundërta politike. Në 5% të diskutimit është vërejtur mosrespektim, ndërsa në 15% është vërejtur mosrespektim i pjesshëm. Krahasuar me

periudhën e mëparshme (korrik - dhjetor 2019), shkallët e mosrespektimit ose mosrespektimit të pjesshëm të personalitetit të deputetëve të partisë tjetër, shënuar rritje për 6 përkatësisht 3 pikë të përqindjes. Në këto raste, folësit në diskutimet e tyre shprehën mosrespektim të plotë ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë - duke përdorur fjalim fyjes. Për dallim nga periudha e mëparshme (korrik - dhjetor

2019) kur në 77% të diskutimit deputetët nuk shprehën asnjë qëndrim ndaj personalitetit të folësve të tjerë, këtë periudhë deputetët nuk shprehën asnjë qëndrim ndaj personalitetit të të tjerëve vetëm në 49%, që do të thotë se deputetët vendosën të adresojnë personalitetin e folësve të tjerë në masë më të madhe me respektimin e pjesshëm ose mosrespektim.


Grafiku 12. Raporti ndaj personalitetit të deputetëve të partie tjetër (%)



Në periudhën gusht - dhjetor 2020, deputetët iu referuan më shumë personalitetit të bashkëbiseduesit sesa argumenteve të tjetrit, për dallim nga periudha e mëparshme (korrik - dhjetor 2019), kur situata ishte e kundërt. Në 58% të diskutimit të tyre ata nuk shprehën asnjë qëndrim ndaj argumenteve të tjetrit, ndërsa

ndaj personalitetit të tjetrit nuk shprehën asnjë qëndrim në 49% të diskutimit. Ky qëndrim është indikator se deputetët në periudhën raportuese i referohen më shumë karakteristikave personale të bashkëbiseduesve, sesa shqyrtimit thelbësor të argumenteve të tyre.

Grafiku 13. Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit të deputetëve të partie tjetër (%)




■ **Qëndrimi ndaj argumenteve dhe personalitetit sipas përkatësisë politike të deputetëve**

Deputetët e pushtetit nuk kishin referencë në 52% të diskutimit të tyre, ndërsa në 17% të rasteve ishte vërejtur respektim i pjesshëm ose respektim. Në 32% të diskutimit, është vërejtur mosrespektim i pjesshëm ose mosrespektim i argumenteve të opozitës. Deputetët e opozitës në 63% të fjalimeve të tyre nuk kishin asnjë referencë, përkatësisht

nuk shprehën ndonjë qëndrim respekti apo mosrespektimi ndaj argumenteve të deputetëve të pushtetit. Në 25% të diskutimit të tyre ata shprehën mosrespektim të pjesshëm ose mosrespektim të argumenteve të shumicës, ndërsa respekt i pjesshëm ose mosrespektim u shpreh në 12% të diskutimit të tyre.


Grafiku 14. Qëndrimi ndaj argumenteve të tjetrit sipas përkatësisë politike (%)



Lidhur me personalitetin e deputetëve të tjerë, në fjalimet e pushtetit në 3% është shprehur respekt, në 30% respekt i pjesshëm, në 14% mosrespektim i pjesshëm, dhe në 5% mosrespektim. Në 49% të diskutimeve, deputetët e pushtetit nuk kishin referencë për personalitetin e deputetëve të tjerë. Deputetët e opozitës në 2% shprehën respekt, në 28% të diskutimeve të analizuara kishin respekt të pjesshëm, në 16% mosrespektim të pjesshëm dhe në

5% mosrespektim të plotë. Në 49% të diskutimit të tyre, deputetët e partive të tjera politike nuk iu referuan personalitetit të deputetëve. Krahasuar me periudhën e mëparshme (korrik - dhjetor 2019), numri i fjalimeve në të cilat deputetët e pushtetit dhe opozita nuk kanë asnjë referencë ndaj personalitetit të tjetrit, është ulur për 25% në llogari të respektit të pjesshëm të personalitetit të folësve të tjerë.


Grafiku 15. Qëndrimi ndaj personalitetit të tjetrit sipas përkatësisë politike (%)



Gjatë kësaj periudhe, deputetët e pushtetit shprehën respekt ndaj argumenteve të anëtarëve të jashtëm në 18% të diskutimit të tyre, ndërsa në 5% u shpreh respekt i pjesshëm. Mosrespektimi i pjesshëm dhe mosrespektim u shpreh në 2% të diskutimit, ndërsa në 75% të diskutimit ata nuk iu referuan argumenteve të anëtarëve të jashtëm. Ndryshe nga pushteti, opozita shprehu respekt për argumentet e pjesëmarrësve të jashtëm

në vetëm 2% të diskutimit, ndërsa respekt të pjesshëm në 6% të diskutimit të tyre. Ata shprehën mosrespektim të pjesshëm në 8% të diskutimit, ndërsa mosrespektimi i argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm u shpreh në 11% të diskutimit. Deputetët e opozitës në 72% të diskutimit të tyre nuk kishin asnjë referencë ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm në diskutim.

Grafiku 16. Qëndrimi ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm (%)




Kur bëhet fjalë për qëndrimin e deputetëve ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm, deputetët e pushtetit në 4% të diskutimit të tyre shprehën respektim, ndërsa në 26% respektim të pjesshëm. Respekt i qartë u shpreh vetëm në një rast. Në 1% të diskutimit shprehën mosrespektim të pjesshëm, ndërsa në 68% të diskutimit nuk kishin asnjë referencë. Deputetët e opozitës shprehën respekt eksplicit vetëm në një diskutim, ndërsa respekt për pjesëmarrësit e jashtëm në diskutim në 2% të fjalimeve të tyre. Në 21% të diskutimeve, shprehën respekt të pjesshëm - kjo do të thotë që

deputetët nuk rezistuan në debate të përdorin shprehje tallëse ose shprehje të buta fyese dhe sulme ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm në diskutim. Në 8% të diskutimit u vërejt mosrespektimi i pjesshëm, ndërsa në 3% të diskutimit u shpreh mosrespektim - në këto raste, folësit në diskutimet e tyre shprehën mosrespektim të plotë për personalitetin e pjesëmarrësve të jashtëm - duke përdorur fjalim fyese. Deputetët e opozitës nuk shprehën ndonjë qëndrim ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm në 67% të diskutimit të tyre.

¹² External participants are all participants in the discussions in the Assembly of RM who are not MPs.

Grafiku 17. Qëndrimi ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm (%)



Deputetët edhe në këtë, si në periudhat e mëparshme, rrallë përdornin tregime, anekdota ose dëshmi në diskutimet e tyre. Elementë të tillë vërehen në gjithsej 1% të diskutimeve.

Në diskutimet, nuk u vërejt asnjë ndërprerje në fjalimet e folësve nga deputetë të tjerë. Këto janë

ndërprerje që zgjasin deri në 10 sekonda, më shpesh të shkaktuara nga deputetë të cilët për momentin nuk kanë fjalë, dhe u hedhin fjalë nga vendi folësve. Në 1% të diskutimit, u vërejt kufizim, në të cilin folësi sugjeron se është i penguar ose ka pengesë pasive. Në përgjithësi, diskutimi u zhvillua në atmosferë të qetë dhe të korrekte.

VI. Grupet e marginalizuara në Kuvend

Gjatë monitorimit të cilësisë së debatit në Kuvend, kemi përfshirë në analizë grupet e marginalizuara dhe sa deputetët u referohen nevojave dhe të drejtave të grupeve të marginalizuara në fjalimet e tyre. Në periudhën gusht - dhjetor 2020, në 93,1% të fjalimeve të tyre, deputetët nuk adresuan të drejtat dhe nevojat e grupeve të marginalizuara. Është vërejtur se deputetët në pjesën më të madhe të fjalimeve të tyre nuk adresojnë të drejtat e grupeve të marginalizuara përveç nëse diskutohet specifikisht për ligj konkret ose

çështje e rendit të ditës janë të drejtat e tyre. Duhet të kihet parasysh se shumica e ligjeve ndikojnë në mënyrë të ndryshme mbi grupe të ndryshme të qytetarëve, dhe të gjitha aspektet duhet të përfshihen në shqyrtimin e tyre. Në diskutimet e monitoruara në këtë periudhë, më të përfshirë në diskutim, edhe pse në përqindje të vogël, janë të rinjtë (2,7%), ndërsa më pak të përfshirë kanë qenë të moshuarit, prindërit e vetëm dhe komuniteti LGBT +.

Tabela 2. Претставување на маргинализирани групи (%)


Marginalized groups	Speeches (%)	Speeches (number)
People with disabilities	1.2	20
Social welfare beneficiaries	0.3	5
Unemployed people	0.1	2
Elderly people	0	0
Roma	0.4	6
Single parents	0	0
LGBTI	0.1	1
Women	1.5	24
Citizens in rural areas	0.9	15
Young people	2.7	43
Other	0.4	7
None	93.1	1494

VII. Demografia e folësve

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit të debatit, mund të vërehet se pjesëmarrja e grave në diskutim është 35%, që paraqet rënie prej 3 pikë të përqindjes krahasuar me periudhën e mëparshme. Gjithashtu, ka pasur rënie të pjesëmarrjes së deputetëve me arsim të lartë, në llogari të deputetëve me studime

të përfunduara të magjistraturës dhe doktoraturës. Nga ana tjetër, vërehet rritje e pjesëmarrjes së deputetëve shqiptarë në diskutim, ku për dallim nga periudha korrik - dhjetor 2019, kur pjesëmarrja e tyre është rreth 7%, përkatësisht në periudhën aktuale pjesëmarrja e tyre në diskutim është 15%.

Grafiku 19. Struktura demografike e folësve (%)



VIII. Shtojcë 1 – Indeksi i cilësisë së debatit

Indeksi i cilësisë së debatit është një indeks i përbërë nga disa tregues që burojnë nga monitorimi i debatit. Indeksi krijohet në disa

faza, ky ajo e fundit është shuma e vlerave të ponderuara të treguesve individualë. Në indeksin hyjnë:

Tabela 1.

Emri	Shkalla	Pjesëmarrje në shumën finale (%)
Shkalle e arsytimit	[-1:1]	20
Përfshirje e arsytimi	[-1:1]	5
Përgjegjësi	[-1:1]	20
Fuqia e argumentit më të mirë	[-1:1]	20
Raport ndaj pjesëmarrësve nga pari tjetër	[-1:1]	10
Raport ndaj argumenteve të pjesëmarrësve nga parti tjetër	[-1:1]	10
Raport ndaj pjesëmarrës të jashtëm	[-1:1]	2,5
Raport ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm	[-1:1]	2,5
Ndërprerje	[-1:1]	5
Kufizim	[-1:1]	5

Për qëllime të indeksimit, te secili indikator u ndanë vlerësimet për kategori të caktuara.

Notat jepen në tabelën në vijim:

Tabela 2.

Shkalle e arsytimit	vlerësime	Përfshirje e arsytimit	vlerësime
Më tepër se 2 argumente	4	Parime abstrakte	2
2 argumente	3	E mira e përgjithshme	2
1 argument	2	Grupe të tjera	1
dobët	0	Grupi vetanak	1
Nuk ka	-2	Neutrale	0

Përgjegjësi	vlerësime	Fuqia e argumentit më të mirë	vlerësime
Adreson argumente në mënyrë përkatëse	2	Ndryshim për shkak të argumenteve	5
Pjesërisht i injoron, shtrembëron, adreson argumentet	1	Nuk ka ndryshim, me pozitë të ndryshme, njeh argumente	3
Nuk janë drejtuar argumente pyetje nga folës tjetër	0	Nuk ka ndryshim, mbetet në pozitë, njeh argumente	1
Injoron argumente	-1	Nuk ka ndryshim, nuk njeh argumente	0
Nuk injoron argumente por i shtrembëron	-2	Ndryshim, por jo për shkak të argumenteve	0
		Nuk ka referencë	0

Raport ndaj pjesëmarrës nga parti tjetër	vlerësime
respektim eksplicit	2
respektim	2
respektim i pjesshëm	1
nuk ka referencë	0
mos-respektim i pjesshëm	-1
mos-respektim	-2

Raport ndaj pjesëmarrësve të partisë tjetër	vlerësime
respektim eksplicit	2
respektim	2
respektim i pjesshëmrespect	1
nuk ka referencë	0
mos-respektim i pjesshëm	-1
mos-respektim	-2

Raport ndaj argumenteve të pjesëmarrësve nga parti tjetër	vlerësime
respektim eksplicit	2
respektim	2
respektim i pjesshëm	1
nuk ka referencë	0
mos-respektim i pjesshëm	-1
mos-respektim	-2

Raport ndaj argumenteve të pjesëmarrësve nga parti tjetër	vlerësime
respektim eksplicit	2
respektim	2
respektim i pjesshëmrespect	1
nuk ka referencë	0
mos-respektim i pjesshëm	-1
mos-respektim	-2

Kufizim	vlerësime
Nuk ka	0
Ka pengim pasiv	-1
ka. Folësi vë në pah se është i penguar	-1
Ka ndërprerje fizike	-2

Ndërprerje	vlerësime
Nuk ka ndërprerje	0
Ka ndërprerje	-1

Çdonjëri nga këta tregues u transformua në mënyrë lineare në nën-indekse në një shkallë prej -1 deri në 1, duke e mbajtur llogarinë që

gjatë transformimit, rezultati origjinal të mos e humb shenjën pozitive ose negative. Nga kjo formula e transformimit universal është:

$$i = \frac{2 \times \text{indicator}}{(\max - (-\max))}$$

Për të gjithë indikatorët për ndërprerje dhe kufizim sepse te këto dy indikatorë vlera absolute e vlerësimit më të ulët të mundur është

më i madh se sa vlera e vlerësimit më të lartë të mundur. Si rrjedhojë formula është:

$$i = \frac{2 \times \text{indicator}}{(|\min| - (\min))}$$

Pasi të do të llogariten nën-indekset e indikatorëve individual, për përlllogaritje kalkulohet prej SQI me vlera ponderuara të nën-indekseve sipas pjesës së

dhënë në Tabelën 1. Për pasqyrim më të lehtë, DQI final shndërrohet në mënyrë lineare në një shkallë prej 1 deri në 10 sipas formulës së mëposhtme:

$$DQI = \frac{(10 - 1)}{(1 - (-1)) \times (\text{preDQI} - 1) + 10}$$

Këto përlllogaritje dhe transformime bëhen për çdo fjalim veç-e-veç ndërsa në raportin transmetohet

mesatarja aritmetike të të gjitha fjalimeve nga perioda e monitoruar.

Informacione rreth projektit

Programi Zviceran për Mbështetje Parlamentare (PSP) do të mbështesë përpjekjet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pavarësi përmes ndërtimit të konsensusit, reforma strukturore dhe ndërtimin e kapaciteteve në zhvillimin institucional të Kuvendit; në rolet e tij ligjvënëse dhe mbikëqyrëse; dhe në transparencën dhe llogaridhënien e tij institucional.

PSP-ja, zbatohet nga Instituti Demokratik Nacional, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime, për mbështetjen e planifikimit strategjik të Kuvendit; për reforma në menaxhimin me burimet njerëzore; për vlerësimin e përmirësuar të ndikimit të rregullativës dhe proceset e prokurimit; për përkushtim ndaj të dhënave të hapura dhe përmes matjes së opinionin publik dhe monitorimit të përpjekjeve për reformë, përfshirë edhe për angazhimin më të madh qytetar në proceset e krijimit të politikave.

Informacione rreth IDSCS-ë

IDSCS është tink tenk organizatë, që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integrimet evropiane të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën politike participative. Përmes forcimit të vlerat liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve.

Të dhëna për kontakt, për IDSCS

Adresa: rr. Miroslav Krlezha 52/2, 1000 Shkup
Tel.nr./ Faks: +389 2 3094 760
Posta elektronike: contact@idscs.org.mk

Link

Ky botim është në dispozicion në mënyrë elektronike në:

<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/kuvendi-nen-thjerrez-raporti-nga-vezhgimit-i-cilesise-se-debatit-ne-kuvend-gusht-dhjetor-2020/>



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHETETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Raport monitorimi nr.03/2021

-

**Kuvendi nën thjerrëz: Raport nga
monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend
(gusht - dhjetor 2020)**

Authore: Vlora Reçica dhe Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq

-

shkurt 2021

